



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 415/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Agon Ramadani- Referues, Kimete Gashi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE “MOBELLAND SH.P.K”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me dollapa për nxënës ne shkolla”, me nr.të prokurimit: 632-22-7109-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Gjakovë, me datën 05.12.2022 mori këtë:

V E N D I M

I **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik OE “MOBELLAND SH.P.K”, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 29.08.2022 me numër të protokollit 415/2022, për aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me dollapa për nxënës ne shkolla”, me nr.të prokurimit: 632-22-7109-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KK Gjakovë kurse Njoftimi mbi Vendimin e datës 19.08.2022, i autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës për këtë aktivitetin të prokurimit, Vërtetohet;

II. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, konform nenit 31 paragrafi 5 të Rregullores së Punës të Organit Shqyrtues të Prokurimit;

A r s y e t i m

Me 19.08.2022, Autoriteti Kontraktues – Komuna Gjakovë ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dollapa për nxënës ne shkolla”, me nr.të prokurimit: 632-22-7109-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Gjakovë.

Me datën 22.08.2022, OE "MOBELLAND SH.P.K" ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar nga AK.

Me 29.08.2022 OE "MOBELLAND SH.P.K" ka parashtruar ankesë me (Nr. protokoli: 415/22), kundër njoftimit për dhënie të cituar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim me nenin 113 të LPP ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 09.09.2022, duke i propozuar Panelit Shqyrtues që:

- Ankesa e OE të aprovohet si e bazuar;
- Të anulohet vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

Pretendimi i parë ankimor sipas ankesës nr.415/22 është se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara.

Në rastin konkret, vlerësojmë se mungesa e deklaratës për specifikacione teknike, përbën devijim të vogël i cili devijim nuk përbën ndryshim material dhe nuk e liron OE nga plotësimi i specifikave teknike të kërkuara pasi i njëjti ka vulosur dhe nënshkruar aneksin I-specifikimet teknike të detyrueshme, ka vulosur dhe nënshkruar paramasën me gjitha detajet e produktit, gjithashtu përmes formularit të dorëzimit ka pranuar të gjitha kushtet e AK-së pa rezervë ose kufizim.

Bazuar në gjitha këto që u cekën si më lartë vlerësojmë se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar, se OE rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar deklaratën për specifikime teknike, megjithatë si theksuam më lartë vlerësojmë se kjo nuk përbën ndryshim material ose devijim nga kërkesat dhe kushtet e vendosura nga AK sa përket plotësimit të specifikave teknike.

Pretendimi i dytë ankimor sipas ankesës nr.415/22 është se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, ku në FDT është kërkuar :

"Deklaratë Tatimore Vjetore të Tatimit në të Ardhura ose Korporata të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës, për 3 (tri) vitet e fundit (kopje)".

AK në refuzim të kërkesës për rishqyrtim ka theksuar se OE i rekomanduar për kontratë në vend të deklaratave tatimore të ATK-së, ka ofruar qarkullimin bankarë dhe vërtetimin e ATK-së.

Sa i përket arsyetimit të AK-së se OE ka ofruar vërtetimin tatimor të ATK-së, vlerësojmë se vërtetim tatimorë (me marrëveshje me këste për të shlyer borxhet), nuk dëshmon qarkullimin e as "deklarimin" e tatimit, dhe nuk mund të zëvendësoj kërkesat e pikës 9.1&9.2 të FDT-së.

Bazuar në gjitha këto që u cekën si më lartë vlerësoj se pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar dhe se dëshmia e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat/dëshmitë e kërkuara në dosje të tenderit-FDT pika 9.1&9.2.

Sa i përket pretendimeve ankimore se OE i rekomanduar për kontratë ka manipuluar/falsifikuar dëshmitë nga banka, sqarojmë se ekspertit shqyrtues nuk ka kapacitet profesional e as kompetencë për të trajtuar pretendime të tilla ankimore. Për një pretendim të tillë OE ankues mund ti drejtohet organeve kompetente.

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet e bazuar, në të njëjtën kohë rekomandojmë që të anulohet vendimi i AK-së dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët me ç'rast OE ankues pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues, ndërsa AK nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Konform nenit 24 par.1 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01./2020 Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritohet të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 59, 60 të LPP. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me pretendimin ankimor se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara, PSH këtë pretendim ankimor e klasifikon të pabazuar sepse nuk është kërkesë kualifikuese dhe për këtë nuk mund të eliminohet asnjë OE, kjo është e

përshkruar decidivisht edhe të neni 41.11 i RRUOPP, i cili citon *“Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit”*.

Lidhur me pretendimin e dytë ankimor sipas ankesës nr.415/22 është se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, ku në FDT është kërkuar *“Deklaratë Tatimore Tjetore të Tatimit në të Ardhura ose Korporata të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës, për 3 (tri) vitet e fundit (kopje)”*. PSH këtë pretendim ankimor e klasifikon të pabazuar dhe AK me të drejtë është bazuar tek neni 68, paragrafi 3, i cili citon: *“Nëse për ndonjë arsye të vlefshme, operatori ekonomik nuk është në gjendje të sigurojë referencat e kërkuara nga autoriteti kontraktues, operatorin ekonomik i lejohet që të demonstrojë gjendjen e vetë ekonomike dhe financiare përmes dokumentit tjetër që autoriteti kontraktues, në ushtrimin e diskrecionit të tij të arsyeshëm, e konsideron të përshtatshëm.”*. Andaj, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një dokument i cili është lëshuar nga Banka dhe me vetë faktin se është rekomanduar për kontratë, ky dokument qenka i përshtatshëm për AK.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: *“Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...”* Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Në ndajshesë të lartcekurave, Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Vedat POTERQOI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna Gjakovë;

1x1 OE- "MOBELLAND SH.P.K";

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.